

Të punosh në Itali
Tekste prezantimi në ppt

Slide 1 TË PUNOSH NË ITALI

Slide 2 SHTETASIT E HUAJ DHE PUNA

Për të punuar në Itali ka rregulla të veçanta për:

- shtetasit e BE-së
- shtetasit jashtë BE-së

* Janë shtetas të BE-së emigrantët që vijnë nga 27 vendet e Bashkimit Evropian

* Të gjithë të tjerët quhen shtetas jashtë BE-së

Slide 3 SHTETASIT E BE-së

Të punosh në Itali

- shtetasit të BE-së NUK i nevojitet leja e qëndrimit për të hyrë në Itali
- mund të qëndrojnë në Itali deri në 3 muaj pa leje të veçanta

Për të qëndruar më shumë se 3 muaj

- duhet të vërtetojë që punon dhe ka shtëpi
- duhet të paraqesë një kërkesë për përfshirje në regjistrin e Komunës ku banon

Slide 4 SHTETASIT JASHTË BE-së

Për të punuar në Itali, shtetasit jashtë BE-së duhet të kenë këto dokumente:

- “nulla-osta” (autorizimi nga Prefektura)
- vizë për arsye pune
- leja e qëndrimit

Slide 5 HAPAT QË DUHEN MARRË PËR TË PUNUAR SIPAS RREGULLAVE

Për të punuar sipas rregullave duhen ndërmarrë disa hapa:

Hapi i parë

- informimi mbi dekretin e flukseve (ligji për hyrjen e punëtorëve në Itali) dhe mbi datën e skadimit

Slide 6

SI VEPROHET ...

Hapi i dytë

- punëdhënësi paraqitet në Sportel dhe bën kërkesë për "nulla osta" për personin që dëshiron të marrë në punë
- "nulla-osta" është autorizimi i parë që lëshon Italia për punëtorin e huaj

Hapi i tretë

- nëse nuk ka probleme, Zyra i jep "nulla osta" punëdhënësit

Slide 7

SI VEPROHET ...

Hapi i katërt

- praktika dërgohet me internet në zyrën konsullore në vendin e origjinës

Hapi i pestë

- nëse punëtori hyn në numrin e caktuar nga ligji, mund të kërkojë vizë për të hyrë në Itali pranë zyrës konsullore në vendin e tij

Hapi i gjashtë

- Konsullata jep vizën dhe informon autoritetet italiane

Slide 8

PAS VIZËS ...

Hapi i shtatë

Punëtori i huaj duhet të shkojë në Sportelin e Përgjithshëm (Sportello Unico):

- për të nënshkruar kontratën
- për të tërhequr formularin dhe për të bërë kërkesën për lejen e qëndrimit

Kujdes

Punëtori duhet ta bëjë këtë praktikë brenda 8 ditëve nga marrja e "nulla-osta", përndryshe është e parregullt

Slide 9

SPORTELI I PËRGJITHSHËM PËR EMIGRACIONIN

Sporteli i Përgjithshëm (Sportello Unico) është një zyrë e Prefekturës që merret me:

- punën
- bashkimin familjar
- lejet e qëndrimit

Slide 10

PËR TË DITUR MË SHUMË

Të punosh sipas rregullave

Për të qenë në përputhje me rregullat, është e nevojshme të kesh një kontratë pune, kur nuk ka kontratë punëtori punon në të zezë

Të punosh në të zezë: do të thotë të jesh jashtë ligjit dhe pa asnjë të drejtë

Për informacione të tjera:

- pyesni pranë një sindikate

Slide 11

KONTRATA E PUNËS

Ka shumë lloje kontratash:

- * Punë e pavarur
- * Me kohë të pakufizuar
- * Me kohë të kufizuar
- * Part time
- * Praktikë
- * E përkohshme
- * Punë autonome
- * Me projekte
- * E rastësishme
- * E rastësishme dytësore

Slide 12

DETYRIMET E PUNËTORIT

Punëtori duhet të njohë dhe të respektojë:

- përgjegjësitë (detyrat e punës), oraret dhe datat e shkruara të përfundimit në kontratë
- rregullat e kompanisë
- rregullat e sigurisë (link)
- rregullat për sëmundjet

Slide 13

TË DREJTAT E PUNËTORIT

Marrja në punë me shkrim (1 kopje për punëtorin) me:

- datën e marrjes në punë
- përgjegjësitë (detyrat)
- lloji dhe kohëzgjatja e raportit të punës
- organizimi, niveli dhe kualifikimi
- shpërblimi (paga)

Kujdes

Ekziston një periudhë prove që mund të zgjasë nga 30 ditë deri në gjashtë muaj

Slide 14

TË DREJTA TË TJERA ...

- orari i punës: 40 orë në javë (së bashku me orë shtesë jo më shumë se 48 orë)
- ditë pushimi të paguara: 26 ditë pune (të detyrueshme)
- ditë feste të paguara: 1 ditë pushimi në javë + festat e parashikuara në kalendar
- leje të paguara dhe leje të papaguara
- leje lindje e detyrueshme (2 muaj para lindjes dhe 3 muaj pas lindjes)

Slide 15

QENDRAT E PUNËS

- Janë qendra publike shërbimi për të gjithë punëtorët (link con indirizzi)
- Kur një person humb vendin e punës, regjistrimi në listat e të papunëve, shërben për të marrë asistencën për papunësinë

Slide 16

ASISTENCA PËR PAPUNËSINË

Është një pagë e reduktuar për ata që humbin vendin e punës
Asistencë për papunësi merr punëtori që ka punuar sipas rregullave dhe që ka derdhur kontribute për të paktën një vit

Për informacione të mëtejshme pyesni pranë një sindikate

Slide 17

FJALORTH

marrje në punë: të punosh vartës me kontratë të rregullt

kontratë: marrëveshje mes punëdhënësit dhe vartësit

kontribute: taksa mbi punën

punëdhënës: personi, ndërmarrja, kompania që ofron punën

vartës: person që punon për një ndërmarrje, kompani ose të tjerë që ofrojnë punë

Slide 18 FJALORTH

ditë pushimi: ditë kur pushohet ose ditë kur nuk punohet

ditë feste: festa të përvitshme, festime

asistencë për papunësinë: pagë e reduktuar për ata që humbin vendin e punës

pushim nga puna: prishje e kontratës së punës

lista e të papunëve: regjistri i personave që kërkojnë punë

përgjegjësitë: detyrat, përgjegjësitë e punës

shpërblimi: paga, rroga